



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE SAMOUPRAVNE INSTITUCIJE  
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë  
Ministry of Education, Science & Technology  
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju**

**UDHEZIM ADMINISTRATIV**

**LENDË: PROCEDURAT E ZGJEDHJES SE DREJTORIT TE SHKOLLES**

**NUMER: MASHT [1] 19/2002**

**DATE: 12.nëntorë.2002**

Në bazë të Rregullorës nr.2001/19 të dt. 4 tetor 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve Kalimtare të Vetëqeverisjes në Kosovë,  
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më poshtë MASHT) nxjerr këtë Udhëzim Administrativ:

Neni 1.

**Qëllimi**

- 1.1 Qëllimi i këtijë Udhëzimi Administrativ është të përcaktojë procedurat e zgjedhjes së Drejtorëve të Shkollave të Mesme, Shkollave Fillore dhe Shkollave Speciale.
- 1.2 Drejtorët e shkollave Speciale emërohen drejtpërsëdrejti nga MASHT-i

Neni 2.

**SHPALLJA E KONKURSIT**

- 2.1.Shpallja e konkursit për Drejtor të Shkollave të Mesme,Shkollave fillore dhe shkollave speciale do të bëhet nga MASHT-i
- 2.2.Kandidatët konkurojnë në Zyrën për Zhvillimin e Arsimit të Komunës për pozitën e drejtorit të shkollës përkatëse(emri i shkollës)
- 2.3.I tër procesi do të jetë nën kordinimin dhe drejtimin e një komisioni të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të emruar nga Sekretari i Përhershëm.

### Neni 3

#### KOMISIONI PER ZGJEDHJEN E DREJTORIT TE SHKOLLES

3.1.Komisioni për zgjedhjen e drejtorit të shkollës të themelohet në çdo Komunë.

3.2.Komisioni përbëhet prej:

- a)Një përfaqësues të MASHT-it(kryetarë i komisionit)
- b)Drejtori Komunal i Arsimit
- c)Zyrtari i Lartë i Arsimit.

3.3.Komisioni për zgjedhjen e drejtorit të shkollës do të mbështetet edhe nga dy anëtarë konsultativ :

- 1.Një prind nga Këshilli i prindërve të shkollës dhe
- 2.Një përfaqësues i shkollës.

### Neni 4

#### PROCEDURA E ZGJEDHJES E DREJTORIT TE SHKOLLES

4.1.Emrat e anëtarve të secilit komision zgjedhor dhe dy anëtarëve konsultativ do të shënohen në formularin [A]”Komisioni për zgjedhjen e drejtorit të shkollës”.

4.2.Emrat e kandidatëve që kanë konkuruar do të shënohen në formularin [B]”Lista e kandidatëve”.

4.3.Komisioni për zgjedhjen e drejtorit do t’i shqyrtoj të gjitha kërkesat e kandidatëve dhe pastaj në bazë të kritereve (shkalla e përgaditjes profesionale , përvoja e e punës në arsim rrespektivisht përvoja dhe rezultatet e udhëheqjes në arsim) do të përpilohen një listë e ngusht prej tre(3) kandidatëve për intervistë.Kandidatët e listës së ngusht shënohen gjithashtu në formularin [B].

4.4.Nëse numri i kandidatëve që kanë konkuruar për drejtorë të një shkolle është më i vogëlse dy920 , atëhere listës së ngusht mund t’i bashkangjitet njëri prej kandidatëve të listës së ngusht të një shkolle tjetër të afërt dhe i cili nuk është kandidat për drejtor në shkollën ku ka konkuruar pas intervistës.

4.5.Komisioni para fillimit të intervistës do të takohet me anëtarët konsultant ku do të merr mendimin e tyre për kandidatët e listës së ngusht për drejtor të shkollës.

4.6.Komisioni do t’i intervistoj kandidatët e listës së ngusht një nga një dhe do t’i vlersoj ata në bazë të kritereve në formularin [C].

4.7.Komisioni në bazë të rezultateve në intervistëdhe pikave të fituara paraprakisht e formulon listën klasifikuese formulari[D] dhe e dërgon në MASHT.

4.8.Komisioni është i obliguar t'i pëcjell në MASHT këto dokumente:

- a)Formulari[A]
- b)Formulari[B]
- c)Formulari[C]
- d)Formulari[D]

4.9.Dokumentet origjinale do të mbahen për qëllime të protokulimit në zyrën e Zyrtarit të Lartë të Arsimit, kurse kopja e tyre në drejtorinë Komunale të Arsimit.

Neni 5  
EMRIMI

5.1.Sekretari i përhershëm në bazë të rezultatit të vlersimit të bërë nga komisioni bënë emrimin e drejtorit të shkollës.

Neni 6  
KONTRATAT

6.1.Pas marrjës së vendimit për emrim-drejtori i shkollës do ta nënshkruaj një kontratë në të cilën do të shenohen të drejtat obligimet dhe përgjegjësit e drejtorit të emruar.

6.2.Periudha kohore e kontratës pëemrimin e drejtorit të shkollës do të zgjatë tre(3) vjet.

6.3.Kontrata mund të shkëputet edhe më herët nga ana e MASHT-it nëse drejtori tregon rezultate të dobëta në udhëheqjen e shkollës ,ose bënë shkelje të ligjit të aplikueshëm.

Neni 7  
Hyrja në fuqi

7.1.Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me 12 nëntor 2002

Isuf Zeneli  
Sekretar i Përhershëm  
Ministria e Arsimit ,Shkencës dhe Teknologjisë